

CONTRASTIVE STUDY OF THE LEXICON OF RELATED LANGUAGES: ITALIAN AND SPANISH STUDIM KRAHASUES I LEKSİKUT TË GJUHËVE TË PËRAFËRTA: ITALISHT DHE SPANJISHT

SERXHO RAMA

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Spanjolle, Tiranë, SHQIPËRI
E-mail: serxhor@yahoo.com

AKTET VI, 5: 547 - 551, 2013

PERMBLEDHJE

Ky artikull ka si qëllim të analizojë nga pikëpamja krahasuese leksikun e të ashtuquajturave gjuhë të përafërta dhe në mënyrë specifike të miqve të rremë në italisht dhe spanjisht. Objektiviteti kryesor është që të krijohet një material didaktik i dobishëm me qëllim që të arrihet të iden-tifikohet ajo ç'ka është e njëjtë dhe ajo ç'ka është e ndryshme në të dyja gjuhët nëpërmjet një ana-lize rigoroze krahasuese dhe kështu të zvogëlohet në minimum fosilizimi i gabimeve duke u nisur nga një nivel fillestar i të mësuarit.

Fjalët kyçe: italisht, spanjisht, gabime, përkthim, miq të rremë.

SUMMARY

This paper aims at a contrastive analysis of the lexicon of the so called related languages and, specifically, the issue of false friends between Italian and Spanish. The main objective is the creation of useful pedagogic material so Italian and Spanish speakers may identify the similarities and differences between these two languages, through a rigorous contrastive analysis, in order to reduce to a minimum the stagnation into prevalent mistakes at the very start of the learning process.

Key words: italian, spanish, mistakes, translation, false friends.

Hyrje

Jo rrallë jemi ndeshur me idenë se midis gjuhëve të përafërta si italishtja dhe spanjishtja, më shumë se për përkthim duhet folur për zhvendosje verbale: duket sikur përkthyesi vetëm sa kopjon apo transferon nga një letër në një tjetër. A është e vërtetë kjo gjë? Kur fillon të punoj mbi këtë argument në biseda të lirshme me studentët i pyesja nëse termi *gjuhë e përafërt* për ta ishte sinonim i termit të *gjuhës së lehtë*. Për çudi përgjigja ishte gjithmonë një po e sigurtë dhe pavarësisht çudisë sime ata insistonin duke më përmendur një sentencë të njohur: "Mësimi i gjuhës italiane për një spanjoll dhe anasjelltas, është detyrë e lehtë, sepse folësi dhe dëgjuesi kuptohen shumë mirë, pa shumë përpjekje". Kjo

është ideja që kanë studentët tanë të italishtes (me spanjisht si gjuhë të dytë) kur fillojnë një kurs gjuhe spanjolle. Kjo e ashtuquajtura lehtësi për të mësuar spanjisht shndërrohet në një pengesë që duhet kapërcyer.

Është momenti këtu të theksoj se subjektet që më ndihmuan në realizimin e këtij punimi ishin studentët shqiptarë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës që si gjuhë të dytë kishin italishten, ndërsa si gjuhë të tretë gjuhën spanjolle. Kam shfrytëzuar detyrat me shkrim që ata kanë realizuar në simestrin e dytë të kursit të parë në vitin shkollor 2010 – 2011, si edhe mjaft shënime të tjera që kam marrë gjatë realizimit të ushtrimeve të ndryshme praktike.

Të gjitha gjuhët që rrjedhin nga latinishtja kanë në një masë të konsiderueshme fjalë dhe struktura të ngjashme. Në rastin e italishtes dhe spanjishtes kjo gjë është akoma edhe më e dukshme, sepse niveli “farefisnor” midis këtyre dy gjuhëve është nga më të ngushtit. Sipas Leopardit, poet dhe filolog italian, ekspert gjuhe dhe kërkues i palodhur, në veprën e tij *Lo Zibaldone “La lingua spagnuola e sorella carnalissima della nostra”* (Gjuha spanjolle është motër e një gjaku e gjuhës sonë) (3389: 1174) arsyet e farefisnisë janë të shumta: ngjashmëri strukturale, transparencë leksikore dhe një bazë gramatikore me rrënjë të përbashkëta. Ekuivalenca gati perfekte e sistemit vokalik, për shembull, ia lehtëson punën nxënësit spanjoll që t’i afrohet studimit të gjuhës italiane, sidomos të kuptuarit të të folurit, deri në atë pikë sa që ai beson se mund të kuptohet nga një dëgjues italian pa shumë përpjekje. Gabim i rëndë ky! Në këtë pikë insistoj gjithmonë e më shumë kur fillon viti i ri akademik. U drejtohem nxënësve dhe u them se pikërisht ngjashmëria midis dy gjuhëve që në teori duhej ta bënte më të lehtë mësimin e njëres gjuhë, duke u nisur nga tjetra, rezultojnë të jetë e gënjeshtërt dhe shpesh çon në mësimin keq të këtyre gjuhëve dhe në gabime trashanike në orët e përkthimit. Carlo Tagliavini e konfirmon këtë gjë duke nënvizuar:

Si arriva così al paradosso che un italiano di buona volontà che cominci in pari tempo lo studio dello spagnolo e del tedesco e che coltivi ambedue le lingue con uguale diligenza, dopo un anno conoscerà meglio lo spagnolo che il tedesco, circa un rapporto di 10: 1, dopo due, 8:3, poi di 7:5, ma dopo quattro anni il grado di conoscenza sarà circa uguale, e dopo cinque tradurrà più correttamente dall'italiano in tedesco che dall'italiano in spagnolo (1947).

Qëllimi im, në këtë punim është të analizoj disa probleme që shtrohen në mësimin e spanjishtes nga italianëfolës dhe të nënvizoj se si fakti i të mësuarit të një gjuhe të përafërt sjell më shumë vështirësi kur duam të përkthejmë me korrektësi nga Gj1 në Gj2, në rastin tonë nga Gj2 në Gj3.

Katerin Katerinov profesor i italishtes i Universtitetit për të Huaj në Peruxha ka vërtetuar se

studentët që bënin një numër më të madh gabimesh në orët e italishtes ishin spanjollfolës. Përse? Përse një student polak harxhon më shumë kohë për të folur italisht në krahasim me një student spanjoll, por bën shumë më pak gabime? I njëjti arsyetim është shprehur edhe nga Tagliavini. Vitin e parë të studimit një italian do të flasë pa dyshim më mirë spanjisht se një polak; por në të pestin, studenti polak do të tregojë një dominim më të madh gramatikor të gjuhës se studenti italian dhe një rrjedhshmëri më të madhe në përdorimin e fjalorit. Ajo ç’ka dua të sqaroj me këtë është se problemi nuk qëndron në kombësinë e nxënësit, por te gjuha e tij e parë; dhe për të qenë më të saktë në ngjashmërinë midis Gj1 dhe Gj2, në rastin e studentëve tanë midis Gj2 dhe Gj3.

Eksperienca në orët e përkthimit më ka mësuar se një nxënës i italishtes që studion spanjisht ka nevojë të marrë një konfirmim për atë çka është e ngjashme në të dyja gjuhët dhe sigurisht edhe për atë që është e ndryshme. Duke e përmbledhur, në rastin specifik të nxënësve të italishtes, duhet mësuar që të analizohet gjuha spanjolle duke u nisur nga ajo italiane dhe anasjelltas, d.m.th. duhen analizuar të dyja gjuhët nga pikëpamja përqasëse. Në orët e përkthimit, studimi përqasës i gramatikës është diçka kryesore sepse, duke u nisur nga gjuha e dytë që në rastin tonë është italishtja mund të shmangen ato pengesa që vendosen midis studentit dhe gjuhës me qëllimin për të arritur një nivel të mirë të përkthimit të gjuhës së dytë (së tretë).

Përqasja është një strategji konjitive universale. Nxënësit përdorin procedura të llojit përqasës sidomos në rastin e analogjive të fiksuara midis Gj1 dhe Gj2. Por, kujdes! Kur perceptimi i largësisë midis gjuhës Gj1 dhe Gj2 është minimal, si në rastin e spanjishtes dhe italishtes, rreziku që të shfaqen elementë të caktuar ndotës gjuhësorë është shumë i mundur. Si rrjedhim lind nevoja për të sqaruar disa pika në didaktikën e gjuhëve të ngjashme që, në këtë kontekst janë me origjinë leksikore. Nga këto konsiderata del nevoja për të përshtatur një pikëpamje pedagogjike të duhur për të shfrytëzuar lehtësitë që të jep afërsia duke kontrolluar në të njëjtën kohë aspektet negative.

Studimi përqasës i leksikut

Leksikologjia përqasëse studion krahasimin midis leksikut të Gj1 dhe atij të Gj2. Kur mësohet një fjalor i ri, studenti përballet me kontrastin e pashmangshëm midis këtij fjalori dhe fjalorit të vet. Kjo sepse midis përdorimeve të reja dhe të vjetra verbale ekzistojnë kategori të përhershme vështirësish që mund të varen nga forma dhe kuptimi. Lado ka zbuluar shtatë kategori marrëdhëniesh midis fjalëve të gjuhëve të ndryshme.

Comparing the foreign language vocabulary with that of the native language, we will find words that are:

- (a) *similar in form and in meaning,*
- (b) *similar in form but different in meaning,*
- (c) *similar in meaning but different in form,*
- (d) *different in form and in meaning,*
- (e) *different in their type of construction,*
- (f) *similar in primary meaning but different in connotation, and*
- (g) *similar in meaning but with restrictions in geographical distribution (1968: 82).*

E dyta nga të shtatë kategoritë e Lados – “*similar in form but different in meaning*”- njihet në rrethet e leksikologjisë përqasëse me emrin **miq të rremë** ose **ngjashmëri të rreme**, që nënkupton fjalët e dy gjuhëve të ndryshme që janë të njëjta

ose të ngjashme në formë, por plotësisht ose pjesërisht të ndryshme në kuptime.

Miq të rremë të plotë

Italishtja dhe spanjishtja kanë një numër të rë-ndësishëm fjalësh identike ose gati të tilla, por ajo ç’ka shprehin në secilën prej këtyre gju-hëve mund të ndryshojë në mënyrë të du-k-shme. E gjitha kjo bën që te nxënësi të kri-jo-het një ndjesi e gënjeshtërt se pas një ko-n-ta-kti të parë shumë të sigurtë me gjuhën e huaj – nxënësi kupton gati gjithçka ose të pa-k-tën është ajo çka ai beson – transformohet në pasiguri. Këtë gjë e dëshmojnë gabimet e shu-mta dhe një farë fosilizimi në të mësuar që është e vështirë të shmanget. Ndërkaq, ësh--të e rëndësishme që nxënësi të njohë se çfa-rë është e njëjtë dhe çfarë nuk është në të dy-ja gjuhët. Shpeshherë u paraqes studentëve she-mbullin e fjalës dormitorio, e cila është e njëjtë në formë në të dyja gjuhët, por jo në kuptim: edhe pse të dyja shprehin idenë e të fje-turit, në italisht tregon një dhomë ku mund të flenë shumë persona; në spanjisht një dho-më të thjeshtë për një ose dy persona. Ajo çka është e njëjtë shndërrohet në të ndryshme dhe favorizon shtimin e gabimeve. Midis mi-q-ve të rremë më të njohur po ju kujtoj disa:

| | |
|---|---|
| <i>amo</i> (ita.) = ‘anzuelo’ (sp.) | <i>amo</i> (sp.) = ‘padrone’ (ita.) |
| <i>aceto</i> (ita.) = ‘vinagre’ (sp.) | <i>aceite</i> (sp.) = ‘aceto’ (ita.) |
| <i>asilo</i> (ita.) = ‘guardería’ (sp.) | <i>asilo</i> (sp.) = ‘ospizio’ (ita.) |
| <i>bollo</i> (ita.) = ‘sello’ (sp.) | <i>bollo</i> (sp.) = ‘bernoccolo’ (ita.) |
| <i>burro</i> (ita.) = ‘mantequilla’ (sp.) | <i>burro</i> (sp.) = ‘asino’ (ita.) |
| <i>caldo</i> (ita.) = ‘calor’ (sp.) | <i>caldo</i> (sp.) = ‘brodo’ (ita.) |
| <i>cara</i> (ita.) = ‘querida’ (sp.) | <i>cara</i> (sp.) = ‘faccia’ (ita.) |
| <i>carota</i> (ita.) = ‘zanahoria’ (sp.) | <i>carota</i> (sp.) = ‘faccia tosta’ (ita.) |
| <i>salire</i> (ita.) = ‘subir’ (sp.) | <i>salir</i> (sp.) = ‘uscire’ (ita.) |
| <i>subire</i> (ita.) = ‘sufrir’ (sp.) | <i>subir</i> (sp.) = ‘salire’ (ita.) |

Ne profesorëve këto gabime na bëjnë për të qe-shur, por janë fillimi i një procesi të mësuarit shumë të rëndësishëm. Kur një hispanofon ose italianofon analizon nga pikëpamja krahasuese miqtë e rremë të plotë, zbulon se gjuha që e

mendonin të lehtë vetëm për shkak të afërsisë dhe familiaritetit me Gj1 jo vetëm që nuk është e tillë por ajo që dukej e ngjashme ndoshta nuk është edhe aq.

Miq të rremë të pjesshëm

Janë fjalë ose shprehje në dukje të ngjashme në formë, por që ndryshojnë në nuancat e tyre kuptimore. Fjala *albergue*, për shembull i korrespondon fjalës italiane *albergo* vetëm kur kjo e fundit përdoret me kuptim letrar. Në përdorimin e saj të zakonshëm *albergue* në italisht është *un ostello*. Fjala *apartamento* në spanjisht do të thotë ‘vend banimi i vogël i mobiluar, ndoshta i përbërë vetëm nga një dhomë’; në italisht *appartamento* do të thotë ‘vend banimi i madh e i gjerë’ që në spanjisht i korrespondon fjalës *piso*. Nuk është gjithmonë e përshtatshme të përkthesh fjalën spanjolle *ilusion* me fjalën italiane *illusione*, të cilën fjalori Zingarelli e përcahton si “un inganno dei sensi per cui una falsa impressione viene creduta realtà”. Shembull tjetër domethënës është emri spanjoll *oficina* që nuk i korrespondon fjalës italiane *officina* (*taller*), por fjalës *ufficio*, e cila nga ana e saj nuk i korrespondon fjalës *oficio* në spanjisht, sepse kjo e fundit i korrespondon fjalës italiane *mestiere*. Këto janë nuanca të thjeshta, që për një fillestar mund të shndërrohen në pengesa të vështira për t’u kapërcyer. A është ndërkaq e vështirë të përkthesh miqtë e rremë të italishtes në spanjisht dhe anasjelltas? A është pjesë e punës së mësuesit që t’u shpjegojë nxënësve se familiariteti i dy gjuhëve të huaja nuk nënkupton lehtësi? A na ndihmon përdorimi i gramatikës përjashtë në këtë detyrë? Nuk është synimi im të bie në një retorikë të thjeshtë, por edhe pse përgjigjet për këto pyetje janë të thjeshta për profesorët, akoma edhe sot nuk janë të tilla për nxënësit.

Konkluzione

Është shumë e rëndësishme të sqarohet kjo temë dhe besoj se shembujt e miqve të rremë janë shumë të qartë. Disa fjalë të gjuhës spanjolle kanë forcën për t’i kujtuar nxënësit italianofon dhe anasjelltas, një mori tingujsh dhe imazhesh që e nxisin të bëjë kërkime në gjuhën e tij të parë për ato ekuivalenca dhe ngjashmëri që pa një studim rigoroz përjashtë të gjuhës mund të bëheshin shkak për gabime të rënda në të kuptuarit dhe të përkthyerit e një gjuhe.

A ka Gj1 fuqinë për të na ngatërruar e për të na tradhëtuar? Sigurisht që po. Sa herë që nuk përpunojmë arsyetime përjashtë të ndërgjegjshme se vështirësia më e madhe qëndron pikërisht në atë që në dukje paraqitet e lehtë. Ai që punon me gjuhë të përafërta e di shumë mirë që nuk mund ta fshijë Gj1 duke u shtirur se gjuha e nënës është e parëndësishme. Eksperienca jonë na kujton se në moshë të pjekur (po analizojmë studimin e gjuhëve të përafërta në kuadrin universitar) gjërat e reja mësohen nga ato gjëra që njihen dhe që janë asimiluar. Nga pikëpamja ime, gjithmonë në kuadrin përjashtë, mund të pohoj se një distancë më e madhe strukturale midis dy gjuhëve sjell një vështirësi më të vogël për të mësuar dhe se, nga ana tjetër, një distancë më e vogël strukturale rrit ndjeshëm mundësitë për të bërë gabime.

Shembujt e miqve të rremë janë vetëm fillimi i një studimi i cili sheh në analizën përjashtë një mundësi të madhe për nxënësin për të kuptuar atë çka është e njëjtë dhe atë çka është e ndryshme në të dyja gjuhët dhe pastaj të përballet me më shumë siguri me studimin e Gj2 duke u nisur nga Gj1.

Atëherë nuk na mbetet gjë tjetër vetëm se të pranojmë gramatikën përjashtë, sidomos, në përkthimin e gjuhëve të përafërta. Përjashta, në modalitetet e ndryshme të saj, është një nga strategjitë didaktike më të këshillueshme, pa harruar kërkesën për t’u thelluar në kërkimet shkencore në fushën e mësimdhënies së spanjishtes si GjH. Orët tona të përkthimit janë gjithmonë e më shumë heterogjene dhe metodologjia jonë didaktike duhet të përshtatet gjithmonë e më shumë me tipologjinë e nxënësve, në përputhje me marrëdhëniet e afërsisë midis gjuhëve të përfshira. Kërkesa për një gramatikë të llojit përjashtë, që të analizojë nevojat specifike të një grupi folësish, bëhet çdo ditë më e ndjeshme dhe më e qartë jo vetëm midis profesorëve por edhe midis nxënësve. Gramatika italiane për hispanofonë dhe ajo spanjolle për italianofonë e profesorit të filologjisë italiane të Universitetit të Seviljes Manuel Carrera Diaz është përpjekja e parë për të përpunuar një gramatikë përjashtë të plotë.

Punimi im ka marrë impuls nga dy manualët (Carrera Diaz 1996 dhe 2001) dhe në orët e përkthimit është mbështetur në përvojën praktike dhe të drejtpërdrejtë me studentët gjithmonë kur Gj1 (në rastin tonë Gj2) e tyre është e përafërt me Gj2 (në rastin tonë Gj3).

Bibliografia

BOSELLI. C (1943), *Le sorprese dello spagnolo*, Milano, Le Lingue Estere.

CALVI. M (2004), «Aprendizajes de lenguas afines: español e italiano», *RedELE*, 1, s.p.

CARRERA DÍAZ. M (1996), *Grammatica spagnola*, Bari, Laterza.

CARRERA DÍAZ. M (2001), *Curso de lengua italiana*, Barcelona, Ariel.

LADO. R (1968), *Linguistics across Cultures: Applied Linguistics for Language Teachers*, Ann Arbor, University of Michigan.

LEOPARDI. G (1991), *Zibaldone di pensieri*, ed. G. Placella, Milano, Garzanti, 3 vols.

TAGLIAVINI. C (1947), «Spagnolo e italiano», *Le Lingue Estere*, XII, 12, pp. 261-262 y 275-276 .